

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO		Gjykata Kushtetuese / Ustavni Sud / Constitutional Court	
Njësia org. Org. jed. Org. kod.	DRLSA	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	806
Nr. fletëve No. stranca No. pages	1	Data Datum Data	08.05.2020

GRUPI PARLAMENTAR I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (LDK)

Për: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Kryetares znj. Arta Rama-Hajrizi

Lënda: Përgjigje në Kërkesën e parashtruesve për rastin KO 72/20, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit 24/2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës

Datë: 8 maj 2020, Prishtinë



E nderuara Kryetare e Gjykatës, znj. Arta Rama-Hajrizi

Më datën 30 prill 2020, deputeti Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë parashtruar pranë Gjykatës Kushtetuese Kërkesën në rastin KO72/20, me të cilën kërkohet vlerësimi i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, të 30 prillit 2020, nr. 24/2020, me të cilin z.Avdullah Hoti i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës si kandidat për Kryeministër, për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Në vijim përgjigjet e Grupit Parlamentar të LDK-së sa i përket meritës së rastit.

Grupi Parlamentar i LDK-së në tërësi kundërshton pretendimet e parashtruesve të Kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit 24/2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës.

Përmbledhje e fakteve:

1. Më 25 mars 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së 44 deputetëve, ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme, me një pikë të rendit të ditës: Mocioni për Mosbesimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kuvendi me më shumë se 2/3 e votave, respektivisht me 82 vota PËR, 32 KUNDËR dhe 1 ABSTENIM, votoi mocionin e mosbesimit të Qeverisë. Nga kjo ditë, sipas dispozitave kushtetuese, Qeveria konsiderohet e shkarkuar dhe luan rolin e qeverisë në dorëheqje, respektivisht nuk ka mundësi të ushtrojë kompetencat e saj me kapacitet të plotë.
2. Për dallim nga praktikat e mëhershme parlamentare, në mocionin e 25 marsit 2020, propozuesi i mocionit kërkoi në mënyrë eksplicite krijimin e një qeverie të re, e cila do të adresonte sfidat imediate që i ka vendi¹. Kjo nënkupton shmangien e mundësisë për shpërndarjen e Kuvendit dhe shkuarjen e vendit në zgjedhje të jashtëzakonshme.

¹ Mocioni i Mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës, 25.03.2020

3. Pas votimit të mocionit të mosbesimit, më 01.04.2020, Presidenti e ka ftuar kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje (në vijim LVV) për konsultime, për t'i kërkuar propozimin e LVV-së për kandidatin për kryeministër. Ndërkaq, ka pasur takime me partitë e tjera, por ato konsultimet me to nuk janë konsideruar për çështje të mandatarit apo shkuarje në zgjedhje.

Vetëm pas 5 letrave dërguar LVV-së, Presidenti ka konstatuar se LVV-ja refuzon të dërgojë mandatarin dhe atëherë janë ftuar partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, të cilat janë pyetur nëse janë të gatshme për zgjedhje apo për formimin e qeverisë së re. Në atë takim, përveç VV-së, të gjitha partitë politike parlamentare janë deklaruar për evitimin e zgjedhjeve, ndërsa LDK-ja ka marrë përsipër krijimin e shumicës parlamentare, me dakordimin edhe të disa partive të tjera.

4. Përveç LVV-ës, të gjitha subjektet e tjera politike të përfaqësuara në Kuvend, kërkuan nga Presidenti i Republikës, që në pajtim me Kushtetutën, t'ju jepet mundësia për të krijuar një shumicë të re parlamentare e që do të prodhonte një Qeveri të re të Republikës së Kosovës.
5. Në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe mbështetur në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO 103/14, si dhe duke marrë për bazë vullnetin e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, Presidenti i Republikës, evitoi shpërndarjen e Kuvendit të Republikës dhe ndërmoi veprimet e nevojshme të procesit kushtetues për themelimin e Qeverisë së Kosovës.
6. Presidenti i Republikës së Kosovës, më 2 prill 2020, i dërgoi kërkesën Lëvizjes Vetëvendosje, si subjekt i parë politik, i dalë në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, që të propozojë kandidatin për Kryeministër. Pastaj, deri më 22 prill, Presidenti ia përcolli LVV-së edhe katër kërkesa të tjera radhazi, por LVV-ja në asnjërën kërkesë të Presidentit nuk dërgoi emrin, rrjedhimisht nuk e propozoi kandidatin për Kryeministër. Duhet theksuar se Presidenti i vendit i ka drejtuar LVV-së edhe 4 letra të tjera, me të cilat kërkonte zgjidhje për çështjen e propozimit të mandatarit. Në asnjërën nga letrat që LVV-ja i ktheu Presidentit nuk propozohej emri i kandidatit të ri për Kryeministër. Kjo tregonte qartazi se Lëvizja Vetëvendosje nuk dëshironte ose refuzonte të propozonte kandidatin e saj.
7. Më 22.04.2020, Presidenti i Republikës i dërgoi letër Kryetarit të LVV-së, përmes së cilës konstaton se LVV nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për propozimin e kandidatit të ri për ta formuar Qeverinë, në pajtim me vendimin e KQZ-së për certifikimin e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
8. Në rrethanat e krijuara, meqë subjekti i parë politik nuk e propozoi kandidatin për Kryeministër, Presidenti i Republikës, më 22.04.2020 e mbajti edhe një takim të përbashkët konsultativ me subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend. Të gjitha subjektet politike, përveç LVV-së, e përsëritën qartazi qëndrimin e tyre se nuk janë për zgjedhje në këtë fazë dhe se dëshirojnë që t'u jepet mundësia për të krijuar një

shumicë të re parlamentare, respektivisht themelimin e një Qeverie të re. Kërkesa që vendi të mos shkojë në zgjedhje në këtë fazë, përveç tjerash, u arsyeua edhe për faktin se ndodhemi në gjendje emergjente, për shkak të pandemisë COVID-19 dhe pasojave të sa, ndërsa shkuarja eventuale në zgjedhje do të rrezikonte shëndetin e qytetarëve të Republikës.

9. LDK, si subjekti i dytë politik, i dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit, me 28 deputet, me vetëm një deputet më pak sesa subjekti i parë, pas 22 prillit 2020 filloi konsultimet me partitë parlamentare për të krijuar shumicë të re parlamentare.
10. Më 22.04.2020 dhe më 29.04.2020, LDK ka pranuar dy letra nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës, me të cilat i është kërkuar propozimi i kandidatit për Kryeministër.
11. LDK-ja gjatë kësaj periudhë arriti të nënshkruajë marrëveshje me disa subjekte politike për formimin e Qeverisë së re. Këto marrëveshje politike të pasuara edhe me nënshkrimet e deputetëve, garantonin krijimin e një shumicë të re parlamentare dhe me këtë edhe mundësinë e themelimit të Qeverisë së re të Republikës së Kosovës.
12. LDK-ja, më 30 prill 2020, ia dërgoi Presidentit të Republikës emrin e kandidatit të saj për Kryeministër, z.Avdullah Hoti.
13. Më 30.04.2020, Presidenti i Republikës e mandatoi z.Avdullah Hoti² për Kryeministër dhe po të njëjtën ditë Grupi Parlamentar i LDK-së, sipas kërkesës së mbështetur nga 61 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, procedoi kërkesën për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme për datën 2 maj 2020, në orën 13:00, me një pikë të rendit të ditës: Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
14. Më 30.04.2020, deputeti Rexhep Selimi dhe 29 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, parashtruan pranë Gjykatës Kushtetuese Kërkesën në rastin KO72/20 ku kërkohet vlerësimi i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, të 30 prillit 2020, nr. 24/2020, me të cilin z.Avdullah Hoti i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës si kandidat për Kryeministër, për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.
15. Më 1 maj 2020, Gjykata Kushtetuese aprovoi kërkesën e Lëvizjes Vetëvendosje për caktimin e masës së përkohshme deri më 29 maj 2020.

Kundërshtimi i shkeljeve të pretenduara nga parashtruesi i kërkesës:

Duke marrë parasysh këtë përmbledhje të fakteve, si dhe të argumenteve kushtetuese në vijim, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (në vijim GP-LDK), vlerëson se Dekreti i Presidentit të Republikës së Kosovës, i 30 prillit 2020, nr. 24/2020, me të cilin z.Avdullah Hoti i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës si kandidat për

² Dekreti i Presidentit të Republikës 24/2020, datë 30.04.2020

Kryeministër, për të formuar Qeverinë e re të Republikës së Kosovës, është nxjerrë në pajtim të plotë me Kushtetutën dhe se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës pasi të trajtoj meritat e çështjes në rastin KO72/20 ta refuzojë Kërkesën si të pabazuar, për arsyt në vijim:

1. Në kërkesën e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, LVV ka kontestuar kushtetutshmërinë e Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, të 30 prillit 2020, nr. 24/2020, i cili, sipas LVV, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 84 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës "*Presidenti nxjerrë dekrete në pajtim me këtë kushtetutë*".

GP-LDK vlerëson se Presidenti i Republikës ka të drejtë të nxjerrë Dekrete, duke u bazuar në kompetencat e tij kushtetuese, në pajtim me nenin 84 pika 4 të Kushtetutës dhe se Dekreti i Presidentit të Republikës së Kosovës është nxjerrë në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës, respektivisht në mbështetje të nenit 84 (paragrafi 4 dhe 14) dhe nenit 95.

2. Parashtruesi i Kërkesës ka pretenduar se Presidenti i Republikës, pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, ka qenë i obliguar që të shpërndajë Kuvendin duke u bazuar në nenin 82 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

GP-LDK vlerëson se Presidenti nuk ka të drejtë që me automatizëm ta shpërndajë Kuvendin sipas nenit 82 pika 2, pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, pa e pasur paraprakisht vullnetin e shumicës së subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend. Në rastin konkret, sikur Presidenti do të shpërndante Kuvendin pa vullnetin paraprak të shprehur nga shumica e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, ai në mënyrë arbitrare do të ndërprente mandatin e deputetëve të Kuvendit, rrjedhimisht do të bënte shkelje të rëndë kushtetuese.

Po ashtu, ne vlerësojmë se neni 82 paragrafi 2 i Kushtetutës nuk ka mundur të përdoret nga Presidenti që me automatizëm të shpërndajë Kuvendin dhe vendin ta dërgoj në zgjedhje, jo vetëm për shkak të ndajfoljes **MUND**, por edhe për faktin se hartuesit e Kushtetutës, momentin kur ka votim të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë nuk e kanë përcaktuar si moment kur vendi automatikisht shkon në zgjedhje, por kanë lënë mundësi që të evitohen zgjedhjet, të krijohet shumicë parlamentare, rrjedhimisht të themelohet një Qeveri e re.

Kjo çështje vërtetohet edhe në Komentarin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku taksativisht thuhet se "*Në krahasim me situatat e lartpërmendur në rastin konkret neni është shumë karakteristik, sepse **Kuvendi i Kosovës MUNDËT (por jo domosdoshmërisht)** të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nëse ndodh votimi i mocioni të mosbesimit*".

* Kushtetuta e Kosovës, neni 84 paragrafi 4 dhe 14, fq 31, si dhe neni 95 fq 37.

*Enver Hasani / Ivan Čukalović, Komentar - KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, faqe,378

Qartazi kjo dispozitë kushtetuese nuk e detyron Presidentin ta shpërndajë Kuvendin menjëherë pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit.

Në fakt, ky është njëri prej pretendimeve më kontradiktore dhe të palogjikshme që haset në Kërkesë, sepse parashtuesi i Kërkesës për fjalën “**mund**” thekson se “nuk përbën dispozitë kushtetuese alternative të mundësisë” (pra, sipas ushtruesit të Kërkesës fjala “mund” nuk paraqet “mundësinë”), ndërsa vetëm pak më poshtë në tekst thuhet se “dispozita e tillë nuk ka karakter alternativ, por ka karakter të lejimit të mundësisë së vetme”, konstatim sa është kontradiktor aq edhe i palogjikshëm, sepse shprehja “lejimi i mundësisë së vetme” nënkupton obligim (që më së miri do të ishte pasqyruar me fjalën “duhet” apo “obligohet” e jo më fjalën “mund”).

Për këtë çështje Gjykata Kushtetuese kishte dhënë vlerësimin e saj edhe në rastin e Aktgjykimit 130/14, ku në pikën 94 shprehimisht thotë: *“Pasi që, sipas Kushtetutës, Presidenti i Republikës përfaqëson shtetin dhe unitetin e popullit, është përgjegjësi e Presidentit të ruaj stabilitetin e vendit dhe të gjejë kritere mbizotëruese për formimin e qeverisë së re, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet.”*

3. Parashtuesit e Kërkesës, në pjesën më të madhe të Kërkesës i referohen nenit 82 paragrafi 2, duke pretenduar që me domosdoshmërinë Presidenti i vendit të fokusonte aty veprimet e tij kushtetuese.

GP-LDK vlerëson se parashtuesi i Kërkesës qëllimshëm nuk e ka përmendur, respektivisht e ka anashkuar nenin 82 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili në mënyrë taksative ka përcaktuar tri momente kur vendi shkon automatikisht në zgjedhje. Pra, janë këto tri momente kur shpërndahet Kuvendi dhe vendi shkon domosdoshmërisht në zgjedhje:

- (1) Nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;
- (2) Nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;
- (3) Nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës⁴.

Në rastin konkret, asnjëra nga këto kushte dhe rrethana nuk kanë ekzistuar që rrjedhimisht të shpërndahet Kuvendi dhe vendi të shkonte me domosdoshmëri në zgjedhje, ashtu siç ka kërkuar dhe pretenduar në vazhdimësi parashtuesi i Kërkesës.

4. Parashtuesi, po ashtu, edhe në pikën 24 të Kërkesës, ka pretenduar se pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, Presidenti është dashur ta shpërndajë Kuvendin sipas neni 82 paragrafi 2 i Kushtetutës. Sipas parashtuesit, Presidenti nuk ka asnjë bazë kushtetuese që të aktivizoj nenin 95 e aq më pak nenin 95 paragrafin 4 të Kushtetutës, për faktin se mungon ura lidhëse me normë kushtetuese ndërmjet nenit 100 paragrafi 6 dhe nenit 95. Parashtuesi, po ashtu, pretendon se ekziston ura lidhëse

⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. K0103/14, pika 94, fq.23

⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 82.1 fq, 29

me normë të shprehur vetëm ndërmjet nenit 100 paragrafi 6 dhe nenit 82 paragrafi 2 i Kushtetutës.

GP-LDK vlerëson se ekziston lidhja substanciale dhe funksionale ndërmjet nenit 100 paragrafi 6, nenit 82 paragrafi 2 dhe nenit 95 paragrafi 4 dhe 5 të Kushtetutës dhe se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për t'ia pamundësuar Presidentit të ushtrojë kompetencat e tij në lidhje me nenin 95 është i paqëndrueshëm, sepse, si i tillë, ia kufizon Presidentit mundësinë që të ushtrojë funksionin e tij në pajtim me nenin 84 paragrafi 2 të Kushtetutës, ku si një ndër kompetencat kryesore të tij theksohet se ai: "*Garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë*". Pretendimet e tilla të parashtruesit të Kërkesës kanë karakter bllokues, sepse tentojnë me çdo kusht të bllokojnë shumicën absolute parlamentare për të themeluar Qeverinë.

Për më shumë, GP-LDK vlerëson se ekziston lidhja kauzale ndërmjet nenit 82 paragrafi 2 dhe nenit 95 paragrafi 4 dhe 5 të Kushtetutës, sepse:

Neni 82 paragrafi 2 i Kushtetutës përcakton se: "*Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë*", ndërsa neni 95 paragrafi 5, përcakton se: "*Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë*".

Lidhja kauzale ndërmjet këtyre paragrafëve kushtetues ekziston për faktin se Qeveria ka rënë (si rrjedhojë e mocionit të mosbesimit) dhe se Presidenti i Republikës ka vazhduar konsultimet me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend për të mandatuar kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.

Ky konstatim bazohet edhe në pikën 90 të Aktgjykimit 130/14, të Gjykatës Kushtetuese, ku thuhet se: "*Ky nen (fjala është për nenin 95 v.j.) qëndron i heshtur në pyetjen se cila parti ose cili koalicion e propozon kandidatin e ri për Kryeministër. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, është në diskrecionin e Presidentit të Republikës që, pas konsultimeve me partitë dhe me koalicionet, të vendosë se cilës parti ose cilit koalicion do t'i jepet mandati për të propozuar kandidatin tjetër për Kryeministër.*"¹⁰

Kjo çështje bëhet edhe më e qartë në pikën 92 të po këtij Aktgjykimi, ku thuhet se: "*Gjykata konsideron se Presidenti i Republikës duhet të vlerësojë se cila është gjasa me e madhe që një parti politike ose koalicion të propozojë kandidatin për Kryeministër, i cili do të marrë votat e nevojshme në Kuvend për formimin e Qeverisë se re.*"¹¹

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 84.2 fq, 31

¹¹ Po aty, neni 82.2 fq 29

¹² Po aty, neni 95.5 fq 37

¹³ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO103/14, pika 90, fq,22

¹⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO103/14, pika 92, fq,23

5. Parashtruesi i Kërkesës ka pretenduar se gjatë këtij procesi Presidenti i Republikës ka vetëm rolin "që përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës".

GP-LDK vlerëson se edhe me Aktgjykimin në rastin Nr. KO103/14, në pikën 60 është përcaktuar se: " Në pajtim me nenin 4.3 të Kushtetutës, ... *Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësuesi legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë*"¹². Prandaj, kompetencat e Presidentit prekin shumë qartë jetën politike në vend, ka rol udhëheqës të procedurës kushtetuese në krijimin e Qeverisë, të cilat janë objekt i çështjes së kësaj Kërkesë.

6. Sa i përket afatit të subjektit për t'ia dërguar emrin e kandidatit për Kryeministër për mandatin tek Presidenti i Republikës, parashtruesi i kërkesës pretendon se ky afat është i pakufizuar në kohë, sepse afati është krejtësisht në ingerencën e subjektit që është fitues relativ i zgjedhjeve parlamentare.

GP-LDK vlerëson se Kushtetuta e Republikës nuk e ka përcaktuar shprehimisht një afat të caktuar në këtë fazë, por ka përcaktuar afatin prej 15 ditësh pas mandatimit nga Presidenti, Kryeministri është i obliguar të paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit.

Hartuesi i Kushtetutës e ka lenë këtë afat të hapur, sepse ka konsideruar se është në interes të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, si dhe është interes publik që Qeveria të themelohet në afatin më të shpejtë të mundshëm. Por, tanimë po vërtetohet se moskaktimi i një "afati të arsyeshëm" për dërgimin e emrit të kandidatit për Kryeministër për t'u mandatuar nga Presidenti i Republikës mund të keqpërdoret deri në abuzim nga fituesi relativ i zgjedhjeve.

Sipas frymës së Kushtetutës, mbetet në detyrimin e Presidentit të Republikës që të shterojë të gjitha mundësitë, brenda një afati optimal, t'ia mundësojë fituesit relativ të zgjedhjeve propozimin e kandidatit për Kryeministër. Në momentin kur vlerëson se fituesi relativ i zgjedhjeve nuk ka vullnet për propozimin e kandidatit për Kryeministër dhe se me çdo kusht po tenton të bllokojë themelimin e Qeverisë së re, Presidenti duhet konsultojë subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe më pas të konstatojë se fituesi relativ nuk ka mundësi të krijojë shumicë parlamentare. Në rastin kur subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend ia dëshmojnë krijimin e një shumice të re parlamentare, Presidenti është i detyruar që, në pajtim me normën kushtetuese, ta dekretojë mandatarin për Kryeministër nga kjo shumicë e re parlamentare.

GP-LDK, po ashtu, vlerëson se Presidenti, në pajtim me dispozitat kushtetuese, pas shkarkimit të Qeverisë më 25 mars 2020, me mocion të mosbesimit dhe pas konsultimit me partitë politike, të cilat përbëjnë shumicën në Kuvendin e Republikës, që janë deklaruar për mos shpërbërjen e Kuvendit, respektivisht evitimit të zgjedhjeve

¹² Kushtetuta e Kosovës faqe , neni 4,pika 3,fq 2

dhe themelimin e një Qeverie të re, më 2 prill 2020 ia ka dërguar LVV, si subjekt politik, fitues relative (29 deputetë) kërkesën për caktimin e kandidatit për Kryeministër. Presidenti, po ashtu, e ka përsëritur edhe katër herë kërkesën e tij për LVV-në, por ajo asnjëherë nuk ia ka dërguar emrin e kandidatit të saj për Kryeministër dhe as që ka shprehur gatishmërinë që do ta bëjë një gjë të tillë.

Ne vlerësojmë se LVV, përveç që nuk e ka dërguar tek Presidenti kandidatin e saj për Kryeministër, ajo asnjëherë nuk ka shprehur gatishmëri për ta themeluar Qeverinë e re. LVV-ja nuk ka ndërmarr asnjë veprim brenda forumeve të saj partiake dhe nuk ka zhvilluar asnjë takim me subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend për të tentuar që të krijojë shumicë të re parlamentare. Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha këto fakte dhe rrethana, mund lehtësisht të konstatohet se LVV-ja qartazi ka refuzuar të caktojë kandidatin e saj për Kryeministër dhe, për më tepër, ka tentuar që të bllokojë themelimin e Qeverisë së re të Republikës së Kosovës.

Duke u gjendur para një situatë të tillë, Presidenti i Republikës, në pajtim me kompetencën e tij kushtetuese të garantimit të funksionimit kushtetues të institucioneve të Republikës, ka mbajtur një takim konsultativ me subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 22.04.2020. Në pajtim me kompetencat e tij dhe në pajtim me pikat 90, 92, 93 dhe 94 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin Nr. KO103/14, Presidenti i Republikës i ka pyetur të gjitha subjektet politike nëse janë për të themeluar një Qeveri apo që vendi të shkojë në zgjedhje?. Të gjitha subjektet politike, përveç LVV-së, kanë shprehur vullnetin e tyre, kundër mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme në këtë fazë dhe se dëshirojnë të shikojnë mundësinë për krijimin e një shumice të re parlamentare dhe krijimin e Qeverisë së re, në pajtim me normën e Kushtetutës.

7. Parashtruesi i Kërkesës shton se qëllimi i mos përcaktimit të afatit për propozim të mandatarit nga partia fituese, në Kushtetutën e Kosovës përcakton të drejtën ekskluzive të partisë fituese që të dërgojë emrin e kandidatit në momentin më të përshtatshëm, kur ajo vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet politike administrative dhe teknike për dërgimin e një emri të tillë.

GP-LDK vlerëson se interpretimi i tillë i Kushtetutës, sipas të cilit arrihet të pretendimi se Presidenti duhet të presë partinë fituese “që të dërgojë emrin e kandidatit në momentin më të përshtatshëm, që ajo vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet politike, administrative dhe teknike”, është krejtësisht i gabuar.

Në radhë të parë nuk është e qartë se çka mendohet me “kushte politike, administrative dhe teknike”.

Pastaj kush dhe si (cilat janë kriteret) do të bëjë vlerësimin se janë përmbushur kushtet e tilla dhe zgjidhja e tillë eventuale, do të sjellte deri te “ngërqet politike” (siç thekson ushtruesi i kërkesës) dhe deri te pengimi i funksionimit demokratik të institucioneve të vendit.

8. Me pikat 90, 92, 93, 94 si dhe shkronjat “c”, “dh” dhe “e” të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin Nr. KO103/14, është përcaktuar se:

Pika 90. "Ky nen qëndron i heshtur në pyetjen se cila parti ose cili koalicion e propozon kandidatin e ri për Kryeministër. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, është në diskrecionin e Presidentit të Republikës që, pas konsultimeve me partitë dhe me koalicionet, të vendosë se cilës parti ose cilit koalicion do t'i jepet mandati për të propozuar kandidatin tjetër për Kryeministër".

Pika 92. "Gjykata konsideron se Presidenti i Republikës duhet të vlerësojë se cila është gjasa me e madhe që një parti politike ose koalicion të propozojë kandidatin për Kryeministër, i cili do të marrë votat e nevojshme në Kuvend për formimin e Qeverisë së re".

Pika 93. "Gjykata rithekson se neni 95, paragrafi 4, i Kushtetutës kërkon që të ketë një kandidat tjetër për Kryeministër, por e le të hapur çështjen se cilës parti ose cilit koalicion do t'i jepet mandati për të propozuar kandidatin për Kryeministër".

Pika 94. "Pasi që, sipas Kushtetutës, Presidenti i Republikës përfaqëson shtetin dhe unitetin e popullit, është përgjegjësi e Presidentit të ruajë stabilitetin e vendit dhe të gjejë kritere mbizotëruese për formimin e qeverisë së re, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet".

c. "Partia ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend, siç përcaktohet në nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, nënkupton partinë ose koalicionin që ka shumicën e vendeve në Kuvend, qoftë shumicën absolute, qoftë atë relative".

Në paragrafin "dh" të këtij Aktgjykimi thuhet: "Në rast se kandidati i propozuar për Kryeministër nuk merr votat e nevojshme, Presidenti Republikës, në diskrecionin e tij/saj, në baze të nenit 95, paragrafi 4, të Kushtetutës, emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, pas konsultimit me partitë ose me koalicionet (e regjistruara në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme) që kanë plotësuar kriteret e lartpërmendura, pra me parti ose me koalicion që është regjistruar si subjekt zgjedhor në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, e ka emrin në fletëvotim të zgjedhjeve, ka marrë pjesë në zgjedhje dhe ka kaluar pragun".

e. "Nuk përjashtohet që Presidenti i Republikës të vendosë t'i japë partisë ose koalicionit të parë, sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, mundësinë të propozojë kandidatin tjetër për Kryeministër"¹³.

¹³ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. K0103/14, pika 90,92,93,94, shkronjat c,dh,e fq.22,23 dhe 24

GP-LDK vlerëson se të gjitha referencat e lartshënuara që derivohen nga Aktgjykimi në rastin Nr. KO103/14 janë mjaftueshëm të qarta për t'i dhënë përgjigje kundërshtuese pretendimeve të parashtruesve të Kërkesës.

9. Parashtruesi, duke u përpjekur për të argumentuar më tutje çështjen e "vakumit" kushtetues në aktivizimin e nenit 95 dhe 95 par. 4 të Kushtetutës së Kosovës, ka përdorur si komparacion disa kushtetuta të vendeve të rajonit dhe shteteve të BE-së, si argumente se si nuk mungojnë dispozita kushtetuese në formë të shprehur në krijimin e qeverive të reja pas mocionit mosbesimit ndaj qeverive aktuale.

Kushtetutat referente:

- Kushtetuta e Kroacisë,
- Kushtetuta e Sllovenisë;
- Kushtetuta e Gjermanisë;
- Kushtetuta e Greqisë
- Kushtetuta e Serbisë;
- Kushtetuta e Shqipërisë;
- Korniza Kushtetuese...

GP-LDK vlerëson se shembujt e tillë nuk janë referencë objektive që ndihmojnë argumentet e pretenduesit. Për më tepër dispozitat kushtetuese të Kushtetutës sonë janë tejet të qarta dhe nuk ka hapësirë për dilema kushtetuese. Këtë argument e forcon edhe pika 95 e Aktgjykimit 130/14: "*Prandaj, Gjykata konkludon se dispozitat kushtetuese janë mjaftueshëm të qarta dhe në përputhshmëri me njëra-tjetrën për të çuar deri te formimi i Qeverisë së re në pajtim me vullnetin e votuesve.*"¹⁴

Ne, po ashtu, vlerësojmë se disa prej dispozitave të Kushtetutave të referuara nuk e trajtojnë problemin në atë mënyrë që do të ishte adekuate për trajtimin e situatës në të cilën gjenden institucionet e Kosovës.

Sa i përket dispozitave të referuara të Kornizës Kushtetuese të Kosovës, mund të thuhet se, sikurse të ofronin procedura dhe zgjidhje adekuate për problemin e themelimit të institucioneve kosovare, ato do të ishin inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës dhe nuk do të kishin mbetur vetëm dispozita të karakterit historik.

GP-LDK kërkon nga Gjykata që të PËRJASHTOJ shqyrtimin e Kushtetutës së Serbisë nga analiza krahasuese e ofruar nga parashtruesi i kërkesës. Kjo për shkak se shqyrtimi i një dokumenti ku SHPREHIMISHT mohohet shtetësia e Kosovës, mund të prodhojë pasoja të paparashikueshme kushtetuese dhe politike për vendin.

10. Parashtruesi, po ashtu, pretendon se legjitimiteti demokratik nuk mund bartet të partitë që janë renditur pas vendit të parë në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, për të krijuar qeveri pa fituesin e zgjedhjeve. Sipas tij, çdo përpjekje për të ndryshuar legjitimitetin

¹⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO103/14, pika 95, fq.23

demokratik, të cilin e bart partia fituese e zgjedhjeve, me dispozita kushtetuese që nuk parashihen në Kushtetutë, përbën shkelje kushtetuese.

GP-LDK vlerëson se pretendimet e tilla janë të paqëndrueshme dhe madje absurde. Në një republikë parlamentare, madje me një sistem elektoral proporcional, siç e kemi ne, asnjë fitues relativ i zgjedhjeve nuk e ka monopolin e legjitimitetit demokratik, e aq më pak në rastet kur abstenon/refuzon për të shfrytëzuar të drejtat kushtetuese. Gjykata Kushtetuese kësaj çështjeje ka provuar t'i jep përgjigje edhe me Aktgjykimin 130/14, përkatësisht me pikën 87 ku thotë se: *"Sidoqoftë, Gjykata vëren se nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë (bëhet fjalë për partinë fituese v.j.) do të refuzojë të marrë mandatin"*.

Prandaj, duke u bazuar në këto vlerësime, Gjykata Kushtetuese ka ofruar edhe mundësitë se si të dilet nga një situatë e tillë. Mundësitë e tilla tashmë janë elaboruar disa herë në pjesën e mësipërme të kësaj shkresë.

11. Parashtruesi, po ashtu, pretendon që Presidenti ka bërë veprim antikushtetues kur, pas votimit të mocionit të mosbesimit në Kuvendin e Kosovës, ka ftuar të gjitha partitë politike në konsultim për formimin e Qeverisë së Kosovës.

Vlerësimi ynë është se konsultimet me subjektet politike parlamentare, pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë, bien tërësisht në mandatin kushtetues të Presidenti të vendit që të ndër marrë të gjitha veprimet në përputhje me vullnetin e shprehur të shumicës së subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend.

Ne, po ashtu, vlerësojmë se në situatën kur Kuvendi me mocion të mosbesimit e shkarkon Qeverinë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk i ka dhënë të drejtë Kryeministrit në detyrë që të imponojë shpërndarjen e Kuvendit dhe shkuarjen në zgjedhje, por i ka lënë kompetencë vlerësimit të Presidentit, pasi subjektet politike në Kuvend ti paraqesin dëshminë se kanë shumicë të nevojshme për të themeluar Qeverinë e re. Kryeministri në detyrë, i shkarkuar me mocion nga deputetët e Kuvendit, në asnjë rast nuk mund të imponojë shpërndarjen e Kuvendit në një Republikë parlamentare si Republika e Kosovës. Ndryshe, mocioni i mosbesimit nuk do të kishte kuptim, nëse pas çdo mocioni shpërbëhet vet Kuvendi, sepse mocioni i mosbesimit të Qeverisë ka të bëjë me mandatin e Qeverisë dhe jo me përfundimin e mandatit kushtetues të legjislativit, në këtë rast, Kuvendit të Republikës. Refuzimi i Kryeministrit në detyrë për të propozuar kandidatin për Kryeministër nga subjekti politik që vetë e udhëheq, duhet interpretuar si tentim i Kryeministrit në detyrë për të imponuar shpërndarjen e Kuvendit, në kundërshtim me vullnetin e shprehur të Kuvendit me mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë. Për më tepër, refuzimi për të propozuar kandidatin për themelimin të Qeverisë nga Kryeministri në detyrë, i cili udhëheqë partinë fituese relative të zgjedhjeve mund të konsiderohet si tentim për të uzurpuar pushtetin ekzekutiv në kundërshtim me vullnetin e Kuvendit të Republikës, të shprehur në mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë.

12. GP-LDK, përpos argumenteve kushtetuese të ofruara më lart, me të cilat kundërshtohen fuqishëm pretendimet e paqëndrueshme të parashtruesve të Kërkesës,

ofrojn edhe disa vlerësime mbi domosdoshmërinë e themelimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me kompetenca të plota kushtetuese. Si pasojë e refuzimit të LVV-së për propozimin e kandidatit të ri për Kryeministër, Kosova ka Qeverinë e saj në dorëheqje dhe si e tillë ajo është me kompetenca të kufizuara. Disa nga pasojat e mungesës së Qeverisë me kompetenca të plota kushtetuese mund të jenë:

- Pamundësia e respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit parlamentar ndaj organeve ekzekutive;
- Pamundësia për të proceduar projektligje;
- Pamundësia për të pasur nisma të ndryshme për adresim në Kuvend;
- Pamundësia për të propozuar dhe miratuar pako sociale e fiskale;
- Pamundësia e marrjes së vendimeve për t'i mbështetur bizneset dhe kategori të caktuara shoqërore;
- Pamundësia për të plotësuar dhe ndryshuar Ligjin e Buxhetit;

Për këto arsye, kërkojmë me respekt nga Gjykata Kushtetuese, që:

- I. **TA REFUZOJË** si qartazi të pabazuar kërkesën në rastin KO72/20, të parashtruar më 30 Prill 2020, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nga Rexhep Selimi dhe 29 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- II. **TË KONSTATOJË** se Dekreti i Presidentit të Republikës së Kosovës, i 30 prillit 2020, nr. 24/2020, është në përputhshmëri me dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. **T'UA KUMTOJË** këtë Aktgjykim palëve;
- IV. **TA PUBLIKOJË** këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare; dhe
- V. **TË SHPALLË** që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Bashkëngjitur gjeni:

1. Mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë i datës 20.03.2020 me nr. prot. 07/170/DO-130;
2. Ftesa e Presidentit e datës 22.04.2020 me nr. Prot. 382 me të cilën e fton kryetarin e LDK-së, z. Isa Mustafa në takimin e përbashkët konsultativ me liderët e partive parlamentare;
3. Kërkesa e Presidentit e datës 22.04.2020 drejtuar kryetarit të LDK-së, z. Isa Mustafa për propozimin e mandatarit potencial për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës;

4. Kërkesa e dytë e Presidentit e datës 29.04.2020 drejtuar kryetarit të LDK-së, z. Isa Mustafa i cili kërkon propozimin e mandatarit potencial për formimin e Qeverisë së re;
5. Shkresa njoftuese me nr. Prot. 408 e datës 29.04.2020 e kryetarit të LDK-së, z. Isa Mustafa, me të cilën e njofton Presidentin e Republikës se janë duke biseduar me partnerët e mundshëm për themelimin e Qeverisë së re;
6. Me datën 30.04.2020, kryetari i LDK-së, z. Isa Mustafa, i propozoi Presidentit të Republikës kandidatin e LDK-së dhe të partnerëve tjerë për Kryeministër, zt. Avdullah Hoti;
7. Me datën 30.04.2020, Presidenti i Republikës me nr. e dekretit 24/2020, e mandatoi zt. Avdullah Hoti kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës; dhe
8. Me datën 30.04.2020, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i mbështetur nga 61 deputetë të Kuvendit, dorëzoi kërkesën me nr. prot. 07/197/Do-147 në Kuvend për thirrje të seancës së jashtëzakonshme për votimin e përbërjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Sinqerisht,

Grupi Parlamentar i LDK


Arben Gashi, Kryetar i Grupit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

202 15 55h

07/170/90-130

20-03-2020

Për: Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Nga: Grupi Parlamentar LDK-së

Lënda: Mocion Mosbesimi ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës

Data:

Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Neni 100, Paragrafi 1, dhe në mbështetje të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Neni 30, Paragrafi 1, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës parashtron:

Mocion Mosbesimi ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kërkojmë që ky mocion të trajtohet brenda afateve kohore të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës neni 100 paragrafi 3.1, dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës neni 30 paragrafi 1.

Arsyetim

Qeveria e Republikës së Kosovës erdhi në pushtet me besimin për ndryshim, për një momentum të ri, në aspekt të zhvillimit ekonomik të vendit, sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit, dhe konsolidimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, ndërsa Kryeministri Kurti në më pak se 50 ditë pune, përmes mos veprimit dhe pozicionimit jokonstruktiv në raport me partnerët strategjikë në përgjithësi dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, ka pamundësuar funksionimin e saj.

Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj kanë si shtyllë të palëkundur aspirimin për integrim në strukturat evro-atlantike. Ndër vite është punuar shumë që të ndërtohet partneriteti strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në veçanti për themelimin e Ushtrisë së Kosovës. Megjithatë, qëndrimet e Kryeministrit Kurti kanë vënë në diskutim jo vetëm përkrahjen për Ushtrinë e Kosovës, por edhe kanë rrezikuar që të tërhiqen trupat amerikane nga Kosova, gjë që do ta rrezikonte automatikisht sigurinë dhe paqen në vend.

Mbështetja e siguruar ndër vite nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me ritjen e prezencës ekonomike amerikane, në vend për të asistuar në zhvillimin ekonomik, ka pësuar regres kohët e fundit si pasojë e kokëfortësisë politike të Kryeministrit Kurti, gjë që ka rezultuar në një

situatë ku Qeveria Amerikane bllokoi Fondet e Korporatës së Sfidave të Mileniumit (MCC) dhe tërheq një ndër investimet strategjike të parapara në sektorin e energjisë.

Përveç mosveprimit në lidhje me tarifën dhe shkaktimit të një krize potenciale me partnerët e jashtëm, Kryeministri Kurti shkaktoi edhe krizë të brendshme politike së fundmi, pikërisht në kohën kur vendi ka nevojë për unitet të brendshëm, angazhim të plotë institucional për të luftuar me pandeminë dhe solidaritet me popullin.

Shkarkimi i ministrit të Punëve të Brendshme, pa konsultim paraprak me partnerin e koalicionit, si dhe pa marrë miratimin e Kryetarit të LDK-së, siç është përcaktuar në marrëveshjen e koalicionit ndërmjet VV-së e LDK-së, me pretekstin se ministri ka deklaruar se gjendja e jashtëzakonshme është mjet i duhur për të adresuar krizën me virusin COVID-19, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me marrëveshjen për qeverisje me partnerëve. Kryeministri Kurti, në betejë me Presidentin për protagonizëm, vendosi të rrethojë bazën politike të qeverisë së tij, duke hequr dorë kështu, në mënyrë indirekte, nga përgjegjësia për të qeverisur.

Duke ritheksuar problematikën e rëndësishme strategjike - veçanërisht në kontekstin aktual - të partneritetit me SHBA-të dhe BE-në drejt integritimit euro-atlantik; si dhe sigurinë kombëtare, në situatën emergjente në të cilën ndodhemi, ju bëjmë thirrje deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që, përmes votës së mosbesimit, ta votojnë këtë mocion.

Me këtë veprim, Kuvendi krijon mundësinë e formimit të një qeverie të stabilitetit, me kohëzgjatje të kufizuar, e cila do të adresonte sfidat imediate me të cilat po ballafaqohet vendi, si në pozicionin e politikës së jashtme, ashtu edhe në dinamikën e krijuara brenda vendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

15-554
07/170/00-130
20-03-2020
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA

Za: Predsedništvo Skupštine Republike Kosova

Od : Parlamentarne grupe LDK-a

Predmet: Mocija nepoverenja Vladi Republike Kosova

Dana:

U skladu sa Ustavom Republike Kosova, član 100.1, i u skladu sa Poslovníkom o radu Skupštine Republike Kosova, član 30. 1, Parlamentarna grupa "Lidhja Demokratike e Kosovës", podnosi:

Mociju nepoverenja Vladi Republike Kosova

Tražimo da se ovaj predlog tretiraju rokovima predviđanim Ustavom Republike Kosova, član 100. 3.1, i Poslovníkom o radu Skupštine Republike Kosova, član 30.1.

Obrazloženje

Vlada Republike Kosova došla je na vlast sa ubedenjem za promene, za novi momentum, sa pogleda ekonomskog razvoja zemlje, vladavine zakona, borbe protiv korupcije i za konsolidaciju međunarodnog subjektiviteta Republike Kosova, dok je premijer Kurti u manje od 50 radnih dana, zbog nepostupanja i nekonstruktivnog pozicioniranja u odnosu na strateške partnere u celini i posebno Sjedinjene Države, onemogućilo je njeno funkcionisanje.

Republika Kosova i njeni građani imaju nepokolebljivu težnju za integracijom u evro atlantske strukture. Tokom godina, mnogo je urađeno na izgradnji strateškog partnerstva sa Sjedinjenim Američkim Državama, posebno uspostavljanju Vojske Kosova. Međutim, stavovi premijera Kurtija ne samo da dovode u pitanje podršku kosovskoj vojsci, već su i rizikovali povlačenje američkih trupa sa Kosova, što bi automatski ugrozilo bezbednost i mir u zemlji.

Podrška koju su tokom godina pružale Sjedinjene Američke Države, s rastom američkog ekonomskog prisustva u zemlji kako bi se pomoglo ekonomskom razvoju, poslednje vreme je nazadovala zbog političke tvrdoglavosti premijera Kurtija, što je rezultiralo situacijom gde Vlada SAD-a blokira sredstva Millennium Challenge Corporation (MCC) i povlači jednu od strateških investicija predviđanih u energetskom sektoru.

Pored nepostupanja u vezi tarife i izazivanja potencijalne krize sa spoljnim partnerima, premijer Kurti je nedavno pokrenuo i unutrašnju političku krizu, u vreme kada je zemlji potrebno unutrašnje jedinstvo, puna institucionalna posvećenost u borbi protiv pandemije i solidarnost sa narodom.

Razrešenje Ministra unutrašnjih poslova, bez prethodnih konsultacija sa koalicionim partnerom i bez odobrenja predsednika "LDK"-a, kako je predviđeno Koalicionim sporazumom između VV i DSK, pod izgovorom da je ministar izjavio da je vanredno stanje pravo sredstvo za rešavanje krize sa virusom KOVID-19 u direktnoj je suprotnosti sa sporazumom o upravljanju između partnera. Premijer Kurti, u borbi sa Predsednikom Republike Kosova za protagonizam, odlučio je da potkopa političku bazu svoje vlade, čime se indirektno odrekao odgovornosti za upravljanje.

Ponovno naglašavajući problematiku od strateškog značaja - posebno u trenutnom kontekstu - partnerstva sa SAD-om i EU-om u pravcu evro atlantskih integracija: kao i nacionalnu bezbednost, u vanrednoj situaciji u kojoj se nalazimo, pozivamo poslanike Skupštine Republike Kosova da glasaju o ovom predlogu glasanjem o nepoverenju. Radeći to, Skupština stvara mogućnost formiranja Vlade stabilnosti ograničenog trajanja koja bi odgovorila na neposredne izazove sa kojima je država suočena, kako u spoljnoj politici, tako i u dinamici stvorenoj u zemlji.

Lista e deputetëve nënshkrues

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grupi Parlamentar	Nënshkrimi
1	ARBEN GASHI	LDK	<i>[Signature]</i>
2	Haxhim Beqiri	LDK	<i>[Signature]</i>
3	SPITON DELMANAT	LDK	<i>[Signature]</i>
4	KUJTIM SHALA	LDK	<i>[Signature]</i>
5	SHKUMBIN GASHI	LDK	<i>[Signature]</i>
6	XHAVIT UKA	L.D.K	<i>[Signature]</i>
7	Felix Kushi	LDK	<i>[Signature]</i>
8	ILIRI BEKIRI	LDK	<i>[Signature]</i>
9	ARBAN ABZASHI	LDK	<i>[Signature]</i>
10	REZARTA KESHANI	LDK	<i>[Signature]</i>
11	ILIR FERATI	LDK	<i>[Signature]</i>
12	EDON DUKAKJ	LDK	<i>[Signature]</i>
13	SHKËMBI MANAJ	LDK	<i>[Signature]</i>
14	Luigj Zylgjeri	LDK	<i>[Signature]</i>
15	Freda Durrës	LDK	<i>[Signature]</i>
16	BESA GAXHERRI	LDK	<i>[Signature]</i>
17	ARMEND ZEJNO	LDK	<i>[Signature]</i>
18	Shkëlzen Haxhi	LDK	<i>[Signature]</i>
19	ILIR TASHOLLI	LDK	<i>[Signature]</i>
20	Safeta Mustafaj	LDK	<i>[Signature]</i>
21	Vera Komitaj	LDK	<i>[Signature]</i>
22	Marigona Geci	LDK	<i>[Signature]</i>
23			
24	VALENTINA BULJAKU-BEXHEPI	LDK	V-Bujaku
25	Qendro Maloku	LDK	Q Maloku
26			
27			
28			

ky nënshkrim
është mund
të përdoret
për kalimin
me DSK-në

Lista e deputetëve nënshkrues

Yers. 20, 2020 / Macion

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grupi Parlamentar	Nënshkrimi
1			
2	Time Kodiqaj	AAK	<i>[Signature]</i>
3	Rozita Selmanaj	AAK	<i>[Signature]</i>
4	Teuta Hasler	AAK	<i>[Signature]</i>
5	GJAZELIJA ARBANI	AAK	<i>[Signature]</i>
6	SHKURBAN DEHALIJA	AAK	<i>[Signature]</i>
7	Donat Haradinaj	AAK	<i>[Signature]</i>
8	Donika Kadaj	AAK	<i>[Signature]</i>
9	Pal Selkaj	AAK	<i>[Signature]</i>
10	ALBENA BESHIRIJA	AAK	<i>[Signature]</i>
11	Fazmend Sela	AAK	<i>[Signature]</i>
12	Arden Talaj	AAK	<i>[Signature]</i>
13	Beha Beqes	AAK	<i>[Signature]</i>
14			
15			

Lista e nënshkrimeve të deputetëve

Nr	Emri	Mbiemri	Grupi Parlamentar	Nënshkrimi
1	FATMIR	LIMAJ	NISMA-AGR	
2	ENDRI	SHALA	NISMA-AGR	
3	HAXHI	SHALA	NISMA-AGR	
4	AEDULLONA	BALAS-ARZMANI	NISMA-AGR	
5	MIRLINDA	SOPI-KARAVANI	NISMA-AGR	
6	BEHÇJET	PACOLLI	NISMA-AGR	
7	VEJTON	BERISHA	PLE	
8	ETEM	ARIFI	PAI	
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

22.04.2020

382 22.04.20

Z. Isa Mustafa,
Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës

I nderuar z. Mustafa,

Pas votimit të Mocionit të Mosbesimit ndaj Qeverisë (Vendimi i Kuvendit Nr. 07-V-013, 25.03.2020) do t'i ndërmarr hapat e radhës të përcaktuar sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, ju ftoj që të merrni pjesë në takimin e përbashkët konsultativ me liderët e partive parlamentare për t'i diskutuar hapat e ardhshëm në mënyrë që t'i japim vendit Qeveri me legjitimitet të plotë.

Takimi do të mbahet sot më 22.04.2020, duke filluar nga ora 16:30, në Ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, salla C-301

Me respekt!

Hashim THAKI

President i Republikës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

22.04.2020

Z. Isa Mustafa,
Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës

I nderuar z. Mustafa,

Në përputhje me mandatin tim kushtetues dhe në respektim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. K0103/14,

me qëllim të shmangies së zgjedhjeve të parakohshme, ruajtjes së stabilitetit të vendit dhe në përputhje me urgjencën për t'i dhënë vendit Qeveri të re me legjitimitet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës,

pas konsultimit me të gjitha partitë politike parlamentare dhe pajtimin të shumicës absolute të tyre për të formuar Qeveri të re,

pas mos dërgimit të kandidatit për të formuar Qeverinë nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje, si subjekt politik që ka fituar shumicën relative në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 06 tetor 2019, përkundër kërkesave të dërguara më 2 prill 2020 (Ref. 354), më 10 prill 2020 (Ref. 354/1), më 15 prill 2020 (Ref. 370/1), më 17 prill 2020 (Ref. 370/3), dhe më 22 prill 2020 (Ref. 380),

në përputhje me Kriteret Mbizotëruese për formimin e Qeverisë së re, luteni të propozoni mandatarin potencial për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili duhet të sigurojë se do ta ketë numrin e duhur të votave në Kuvendin e Kosovës dhe të zotohet se do të krijojë Qeveri stabile dhe gjithëpërfshirëse.

Kriteret Mbizotëruese për formimin e Qeverisë së re i bashkëngjiten kësaj shkrese.

Me respekt,


Hashim Thaci
President i Republikës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

29.04.2020

Z. Isa Mustafa,
Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës

I nderuar z. Mustafa,

Jam në pritje të përgjigjes suaj në kërkesën që ua kam bërë në takim in tonë të përbashkët të datës 22 prill 2020, për të propozuar kandidatin/en për Kryeministër dhe formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Siç jeni në dijeni, pas konsultimit publik me të gjithë liderët e partive politike të përfaqësuara në Kuvend (22 prill 2020), liderët e të gjitha partive politike të përfaqësuara në Kuvend, përveç përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, u deklaruan njëzëri që janë për një Qeveri të re dhe që vendi të mos shkojë në zgjedhje. Në këtë takim, po ashtu, para të pranishmëve i kam prezantuar edhe kriteret mbizotëruese për formimin e Qeverisë së re, me qëllim që të shmangen zgjedhjet, duke gjetur rrugë procedurale për krijimin e Qeverisë. Këto kriterë në të njëjtën ditë ua kam dorëzuar edhe juve.

Në përputhje me mandatin tim kushtetues dhe në respektim të Kushtetutës dhe Aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. K0103/14, me qëllim të shmangies së zgjedhjeve të parakohshme, ruajtjes së stabilitetit të vendit dhe në përputhje me urgjencën për t'i dhënë vendit Qeveri të re me legjitimitet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në përputhje me Kriteret Mbizotëruese për formimin e Qeverisë së re, luteni edhe një herë, që pa humbur kohë, të propozoni mandatarin potencial për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili duhet të sigurojë se do ta ketë numrin e duhur të votave në Kuvendin e Kosovës dhe të zotohet se do të krijojë Qeveri stabile dhe gjithëpërfshirëse.

Me respekt,


Hashim Thaçi

President i Republikës së Kosovës



Datë: 29.04.2020

Sh.T.Z. Hashim Thaçi
President i Republikës së Kosovës



I nderuari President Thaçi,

Ju njoftojmë se menjëherë pas pranimi të letrës së juaj, të datës 22 prill 2020, kemi nisur bisedat për krijimin e shumicës parlamentare, për të formuar Qeverinë e re, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në vazhdimësi të asaj letrës, sot më 29 prill 2020 kemi pranuar edhe letren tjetër nga ju.

Ju njoftojmë se jemi në përmbyllje të marrveshjeve me partnerët e mundshëm të koalicionit qeverisës, në harmoni me kriteret mbizotëruëse. Këto ditë kemi kryer shumë takime intensive, që kanë të bëjnë me progamin qeverisës dhe ndarjen e përgjegjësisë qeverisëse.

Jemi duke punuar intensivisht dhe shpresojmë që në të ardhmen shumë të afërt të krijojmë shumicën parlamentare dhe të propozojmë kandidatin për Kryeministër të Kosovës.

Dr. Isa Mustafa
Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës



Datë: 30.4.2020

Sh.T.Z. Hashim Thaçi
President i Republikës së Kosovës




I nderuari President Thaçi,

Në përputhje me Kriteret Mbizotëruese për formimin e Qeverisë së re, të prezantuar nga ana e Juaj në takimin e datës 22 prill 2020, pas konsultimit publik me të gjithë liderët e partive politike të përfaqësuara në Kuvend, dhe konsultimeve gjithëpërfshirëse me subjektet AAK, NISMA Socialdemokrate, AKR dhe subjektet tjera që përfaqësojnë komunitetin joshumicë në Kuvendin e Kosovës, me qëllim të shmangies së zgjedhjeve të parakohshme, ruajtjes së stabilitetit të vendit dhe në përputhje me urgjencën për t'i dhënë vendit Qeveri të re me legjitimitet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i propozojmë Presidentit të Republikës së Kosovës z. Avdullah Hoti, kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës

Dr. Isa Mustafa
Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK



Prishtinë, 30.04.2020

Z. Isa Mustafa,
Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës

I nderuar z. Mustafa,

Bashkëngjitur gjeni Dekretin Nr.24/2020, të datës 30.04.2020, për propozimin e z. Avdullah Hoti, kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Me respekt,


Hashim THAÇI

President i Republikës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

Nr. i Dekretit: 24 /2020

Presidenti i Republikës së Kosovës,
në mbështetje të nenit 84 (pikat 4 dhe 14) dhe nenit 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,
nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L – 094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar
2009), duke marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në Rastin KO 103/14, (1 korrik
2014), si dhe në rrjedhë të propozimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të pranuar nga Zyra e
Presidentit më 30.04.2020 (Nr. Prot.: 409), nxjerr:

DEKRET

1. Z. Avdullah Hoti, i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.
2. Kandidati nga pika 1 e këtij Dekreti, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.
3. Dekreti hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.


Hashim Thaçi
President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, 30.04.2020

Dekreti t'i dërgohet:

- Z. Avdullah Hoti, kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës;
- Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- a/a.



1555

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI - ASSEMBLY OF KOSOVO SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Titulli / Proportim / Titulo / Proportio / Titulo / Proportio / Titulo / Proportio
No. / Titulli / No. / Titulli / No. / Titulli / No. / Titulli
30-04-2020
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Për: Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës
Vjosa Osmani, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Nga: Arben Gashi, Kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhtjes Demokratike të Kosovës, në emër të deputetëve nënshkrues të kërkesës

Lënda: Kërkesë për thirrje të seancës të jashtëzakonshme për votimin e përbërjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës

Data: 30 prill 2020

Në bazë të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 38, (pika 2. c) të Rregullorës së Kuvendit, i paraqesim Kryesisë së Kuvendit kërkesën për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme.

E nderuar Kryetare e Kuvendit znj. Osmani
Të nderuar anëtarë të Kryesisë së Kuvendit,

Në përputhje me Dekretin Nr: 24/2020 i datës 30 prill 2020, të Presidentit të Republikës së Kosovës, Neni 95 paragrafi 5, Neni 67 paragrafi 7 pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe lidhur me Nenin 29 paragrafi 2, Neni 16 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së Kuvendit, kërkoj nga ju thirrjen e seancës së jashtëzakonshme për votimin e përbërjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datën 02.05.2020, në ora 13:00.

Lista e deputetëve nënshkrues

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grupi Parlamentar	Nënshkrimi
1	ARSEN GASHI	LDK	
2	VEJSE RASHI	LDK	
3	MARIBO KALAJA	LDK	
4	BEKTESH NIKOLAJ	LDK	
5	XHAYIT LIKA	LDK	
6	ILIRI HAJRATI	LDK	
7	LANARDE MULLI	LDK	
8	ILIRI KASHOLLI	LDK	
9	LIQITE KALAJA	LDK	
10	FIDAN REXALLI	LDK	
11	SHKUMBIN GASHI	LDK	
12	DEJDA BUKALI	LDK	
13	FATMERE DEMIRI	LDK	
14	SHKEMBI MANAJ	LDK	
15	BESA ÇAKIRARI	LDK	
16	ILIRI FERATI	LDK	
17	KUJTIMI SHALA	LDK	
18	DORIAN SELMANI	LDK	
19	SHKURTEN HAJRATI	LDK	
20	ERON KALAJA	LDK	
21	VALENTINA BULLAJA	LDK	
22	ARBAN ABASHI	LDK	
23	ARMENI ZEMAJ	LDK	
24	MARIGONA LIQI	LDK	
25	ARMENI KALAJA	LDK	
26	ARMENI SHALA	LDK	
27			
28			



ky është lista e deputetëve nënshkrues të grupit parlamentar LDK në Kuvendin e Kosovës për periudhën 2013-2014.

Lista e deputetëve nënshkrues


Nr.	Emri dhe mbiemri	Grupi Parlamentar	Nënshkrimi
1	Pal Sellosj	AAK	Pal Sellosj
2	Time Haxhiu	AAK	Time Haxhiu
3	Teuta Hoxha	AAK	Teuta Hoxha
4	SHKUMBIN DEMALIAS	AAK	Shkumbin Demalias
5	Rozita Felmanaj	AAK	Rozita Felmanaj
6	GARMELD ARRASHI	AAK	Garmeld Arrashi
7	Donita Kadaj	AAK	Donita Kadaj
8	ARBENA BASHIRI	AAK	Arbena Bashiri
9	David Haradinaj	AAK	David Haradinaj
10	Gazmend Sylaj	AAK	Gazmend Sylaj
11	Arben Tahiri	AAK	Arben Tahiri
12	Beli Berisha	AAK	Beli Berisha
13	Ali Berisha	AAK	Ali Berisha
14			
15			

Бр.	Име и презиме	Парламентарна група/партија	Потпис
1.	Зеринџа Перанић	Српска листа	Зеринџа
2.	Николаи Милашић	Српска листа	Милашић
3.	Ivan Todorović	Srpska lista	И
4.	Игор Симић	Српска листа	Игор
5.	Зоран Величковић	Српска листа	Зоран
6.	Душан Кривошеја	Српска листа	Душан
7.	Бранко Николић	Српска листа	Бранко
8.	Јасмина Јежић	Српска листа	Јасмина
9.	Оливера Милошевић	Српска листа	Оливера
10.	SLAVKO SIMIĆ	Srpska lista	С
11.			
12.			

Lista e nënshkrimeve të deputetëve

Nr	Emri dhe mbiemri	Grupi Parlamentar	Nënshkrimi
1	FATMIR LIMAJ	NISMA	
2	ENDRIT SHALA	NISMA	
3	HAXHI SHALA	NISMA	
4	ALBULENA BALAJ HAKIMAJ	NISMA	
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			



Lista e deputetëve nënshkrues

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grupi Parlamentar	Nënshkrimi
1			
2	MIRZINDA SEFI - VHASNIQI	AKR	

Lista e deputetëve nënshkrues

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grupi Parlamentar	Nënshkrimi
1	ADEM HODJA	G+	
2	FILIP DANKU	G+	
3	Eden ALI	G+	
4	ALBERT KANOVA	G+	
5			
6			
7			

Lista e deputetëve nënshkrues

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grupi Parlamentar	Nënshkrimi
1	VISTON BEKTESHA	PA GRUP	
2	ETEM ARIFI	PA GRUP	
3			

Lista e deputetëve nëshkrues

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grupi Parlamentar	Nëshkrimi
1	Auda Bafte	IDK	Auda Bafte
2			